



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21519 Prot.

Lezhë, më 28 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 182 Datë 23 . 12 . 2021

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË”**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a VKM nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Lezhë, si më poshtë vijon:
  - a) Qiraja për strukturën apartament për Garsionierë është 9 300 ( nëntëmijë e treqind) lekë.
  - b) Qiraja për strukturën e apartamentit 1+1, është 13 000 ( trembëdhjetë mijë) lekë.
  - c) Qiraja për strukturën e apartamentit 2+1, është 17 000 ( shtatëmbëdhjetë mijë) lekë.
  - d) Qiraja për strukturën e apartamentit 3+1, është 20 500 (njëzetë mijë e pesëqind) lekë.
2. Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**

